VENDIM
Nr. 3, datë 9.4.2014

PËR SHPALLJEN E THIRRJES SË DYTË PËR NDARJEN E FONDIT PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3 të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, "Për buxhetin e vitit 2014", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes së dytë për projekte të infrastrukturës vendore, për shpërndarjen e fondeve, në vlerën 1 200 000 000 (një miliardë e dyqind milionë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014. Kjo thirrje për aplikim përfshin, si më poshtë vijon:

a) projekte me ndikim në zhvillimin ekonomik dhe me potencial partneriteti;

b) studime dhe projekte me ndikim zhvillimi ndërvendor, rajonal etj;

c) zonat informale dhe projekte të tipit zonë zhvillimi, si dhe të tjera projekte vendore;

2. Aplikimi për fonde të thirrjes së dytë për financimin e projekteve të infrastrukturës vendore, sipas pikës (1) të këtij vendimi, bëhet sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur. Institucionet aplikuese janë njësitë e qeverisjes vendore, si dhe autoritetet dhe agjencitë zhvillimore.

3. Shqyrtimi për financim bëhet për projektet e aplikuara, sipas kalendarit dhe formularit të dhënë në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi. Procedura e vlerësimit kryhet pranë sekretariatit teknik përkatës, në Ministrinë e Planifikimit Urban dhe Turizmit, si dhe pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas kritereve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pasi botohet në Fletoren zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar
Ministri i Financave	Anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar
Ministri i Kulturës	Anëtar
Ministri i Mjedisit	Anëtar
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar

SHTOJCË I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	**Institucioni përgjegjës**	**Aktiviteti**
9 Prill 2014	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Marrja e vendimit për shpalljen e thirrjes së dytë për projekte të infrastrukturës vendore
25 prill 2014	Qendra e Botimeve Zyrtare	Botimi i vendimit të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për thirrjen e dytë të projektaplikimeve për projektet e infrastrukturës vendore
30 prill 2014	Aplikuesit sipas pikës 2 të këtij vendimi (autoritetet dhe agjencitë zhvillimore)	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi online në faqen elektronike: www.dsdc.gov.al dhe/ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (me postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit). 3. Shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit.
30 prill – 5 maj 2014	Sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit)	Vlerësimi teknik i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III.
5 maj 2014	Sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit)	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve me vlerësimin përkatës teknik.
7 maj 2014	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Vlerësimi strategjik i projekteve të aplikuara, sipas pikës B, shtojca III.
7 maj 2014	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Përgatitja e materialeve për vendimmarrje në Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve
8 maj 2014	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR)	Vendimmarrje në lidhje me projektet për t'u financuar, nga thirrja e dytë e financimit për infrastrukturën vendore, si pjesë e FZHR-së.

Shënim

Procesi i vlerësimit

1.Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza. Faza e parë përbën vlerësimin teknik, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi teknik i projekteve, sipas kritereve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit, kryhet nga sekretariati teknik për objektet e infrastrukturës vendore, i ngritur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

2. Sekretariati teknik i paraqet zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, listën e plotë të projekteve me vlerësimin përkatës, të bërë sipas kritereve të përcaktuara në pikën A të shtojcës III, bashkëlidhur vendimit.

3. Faza e dytë e vlerësimit të projekteve bëhet sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I të këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve kryen vlerësimin përfundimtar të projekteve, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën B të shtojcës II, bashkëlidhur vendimit.

SHTOJCË II: FORMATI I APLIKIMIT

Aplikuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues
Titulli i projektit (*)	
Lloji/sektori i projektit (*)	Infrastrukturë vendore
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Data e aplikimit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë të përmbledhur, se: - ku konsiston projekti/studimi; - cilat janë problemet që adreson; - cila është vendndodhja e projektit/vendndodhja e studimit; - rrisqet për zbatimin e tij, ndikimi etj., sipas kritereve mbi bazën e të cilave do të vlerësohet projekti.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Paraqisni qëllimi dhe objektivat e projektit/studimit
Ndikimi ekonomik i projektit (*)	Paraqisni se cili është ndikimi ekonomik i projektit dhe si ndikon në zhvillimin ekonomik të zonës;
Përshkrim i përfituesve të projektit (*)	Cili është përfitimi dhe numri i përfituesve (bizneset; qytetarët etj.) drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga projekti në total
Rendi prioritar (*)	Paraqisni me vendosje rendore, në rastet e aplikimit të më shumë se të një projekti (numri 1 cilëson për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e në vijimësi)
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Paraqisni dhe analizoni nëse projekti përfshin kosto për mirëmbajtjen (nëse po, sa parashikohen kostot dhe si do të sigurohet financimi etj.), ose nëse parashikohen për të ardhmen një kosto për mirëmbajtjen, dhe cili është institucioni që do të merret me mirëmbajtjen.
Rrisku në zbatimin e projektit (*)	Paraqisni dhe analizoni rrisqet e mundshme për zbatimin e projektit; cilët janë faktorët e rriskut; cilat janë masat që do të merren për të mënjanuar rriskun.
Potenciali për partneritet (*)	Paraqisni dhe analizoni cili është potenciali për partneritet që parashikon projekti; nëse projekti mund të tërheqë investime të tjera për zonën; nëse ka aktualisht mundësi konkrete për partneritet me aktorë të tjerë (donatorë; biznesi etj.).
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Paraqisni fondin që kërkohet nga FZHR-ja për financim. Fondi që kërkohet është i njëjtë me financimin total për projektin, në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga donatorë të tjerë.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga aplikuesi	Paraqisni kontributin/bashkëfinancimin (nëse ka) nga aplikuesi.
Financim nga donatorë të tjerë (*)	Paraqisni kontributin/bashkëfinancimin nga donatorët (në rast se ka donatorë që bashkëfinancojnë).
Financime të tjera (*)	Nëse ka burime të tjera financimi.
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një studim fizibiliteti të cilësisë së mirë (*)	Paraqisni me **Po** dhe **Jo**.
Përmbledhje e studimit të fizibilitetit (*)	Paraqisni një përmbledhje e shkurtër e studimit të fizibilitetit, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (*)	Paraqisni me **Po** dhe **Jo**.
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim (*)	Paraqisni një përmbledhje të shkurtër të analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (*)	Të cilësohet me **Po** dhe **Jo**.
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis (*)	Paraqisni një përmbledhje të shkurtër të vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.

Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim (*)	Përshkruani nëse projekti është gati për zbatim: - nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatim; - nëse paraqiten afatet parashikuara për procedurat e prokurimit publik; - nëse paraqiten afatet parashikuara për fillimin dhe përfundimin e zbatimit të punimeve.
Dokumentet e miratimit të projektit nga një autoritet vendimmarrës(*)	Përshkruani statusin aktual të projektit, duke paraqitur nëse: - për projektin ka vendim për miratimin nga ana e autoriteteve më të larta (Bordi, Këshilli respektiv, KKT etj). - Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet numri dhe data e miratimit të vendimit, si dhe të citohet dokumenti.
Përshtatja strategjike (*)	Të paraqitet dhe të specifikohet nëse projekti është: - pjesë e një strategjie rajonale/vendore/kombëtare; - pjesë e një masterplani kombëtar; - pjesë e një plani të investimeve kapitale; - pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se lloji i planit); Për të gjitha rastet e sipërpërmendura, të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo planit, si dhe të citohet dokumenti.
Dokumentet teknike të nevojshme për të plotësuar dosjen (*)	Paraqisni dhe bashkëngjisni dokumentet e mëposhtme: - projektin teknik; - preventivin; - argumentimin teknik; - përllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit; - kalendar të kryerjes së investimit (*cash flow*); - studimet e fizibilitetit (nëse ka); - vlerësim ndikimi në mjedis (nëse ka); - analizë kosto–përfitim (nëse ka); - analizë rrisku (nëse ka);

(*) Fushat që kanë shenjën (*) janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

Shënim. Dërgimi i aplikimeve sipas afatit

1. Aplikimet për projekte dërgohen në:

a) Aplikimi online në faqen elektronike: www.dsdc.gov.al, dhe/ose

b) Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

2. Përveç formatit të aplikimit si më lart, institucionet aplikuese dërgojnë shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve me njoftimin e dërgimit të aplikimit pranë sekretariatit teknik dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit që i jepet nga aplikanti.

SHTOJCË III: KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Pika A. Kriteret e vlerësimit teknik

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi maksimal me 70 pikë i projektit. Kriteret (1) dhe (2) detajohen në nënkritere përkatëse teknike nga sekretariati teknik për projektet e infrastrukturës vendore, i ngritur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga aplikuesit. Ky kriter nënkupton se projektet janë detajuar saktë dhe qartë teknikisht. Kostimi dhe preventivimi janë përpiluar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve, etj. Ky kriter vlerësohet me 0 deri maksimalisht 20 pikë.

2. Niveli i ulët i rriskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi rriskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Projekti rekomandohet të ketë një analizë të rriskut. Ky kriter vlerësohet me 0 deri maksimalisht 10 pikë.

3. Ndikimi ekonomik i projektit, sipas komponentëve, si më poshtë vijon:

- Projekte me ndikim në zhvillimin ekonomik të zonës, në zhvillimin e biznesit, të SME-ve, sektorëve ekonomikë, si edhe të turizmit. Për këtë, nevojitet të argumentohet duke paraqitur të dhëna mbi natyrën e bizneseve, apo SME-ve përfituese nga projekti (industri turistike, industri e lehtë përpunuese, biznese facon, etj). Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në maksimalisht 10 pikë.

- Projekt me karakter ndërvendor, me potencial partneriteti (nëse përfaqëson interesat e më shumë se dy njësive vendore). Kriteri inkurajon ato projekte që kanë ndikim sa më të gjerë në konsolidimin e strukturës ekonomike të zonave të ndryshme. Për këtë komponent vlerësimi përfshin 0 deri 10 pikë.

4. Potenciali që paraqet për partneritet projekti, duke argumentuar përmes paraqitjes së natyrës, dobisë, funksionit të partneritetit, si edhe nivelit të bashkëfinancimit nga partnerët dhe donatorët. Ky kriter vlerësohet me 0 deri në maksimalisht 10 pikë.

5. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si studimi i ndikimit në mjedis, analiza kosto-përfitim, studimi i fizibilitetit të projektit etj. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me 0 deri maksimalisht 5 pikë.

6. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me 0 deri maksimalisht 5 pikë.

Pika B. Kriteret e vlerësimit strategjik

Përdoren nga sekretariati i përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar në nivel vendor, qarku apo kombëtar, duke

vlerësuar një projekt me maksimalisht 30 pikë, sipas kritereve në vijim:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal/kombëtar dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonal/kombëtar. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 10 pikë.

2. Potenciali për zhvillim ekonomik, qëndrueshmëria e projektit, si edhe potenciali për tërheqjen për investime të reja dhe/apo faza të reja të zhvillimit, që paraqet projekti. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.

3. Potenciali për zhvillim dhe integrim urban, lidhur me zonat informale kryesisht. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 5 pikë.